

DEKLARATË [KONTRATË] **PËR NDËRMARRJEN E NJË ZOTIMI TË PËRBASHKËT PUBLIK**

Në Tiranë, sot më 25 Korrik 2019,

Ne, qytetarët dhe artistët e angazhuar për mbrojtjen e Teatrit Kombëtar,

dhe Partia Demokratike e Shqipërisë dhe opozita e bashkuar,

1.1. Duke e konsideruar ndërtesën e Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Eksperimental, si dhe zonën përreth tij, si pjesë të patjetërsueshme të Qendrës Historike të Tiranës, si dhe me vlera të padiskutueshme historike dhe pjesë të trashëgimisë kulturore;

1.2. Duke qenë krenarë dhe të vetëdijshëm për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe me përgjegjësinë për të ruajtur trashëgiminë tonë historike e kulturore dhe mbrojtur e forcuar vlerat shpirtërore të vendit;

1.3. Duke i vlerësuar si antikombëtare dhe të paligjshme përpjekjet për shkatërrimin e ndërtesës historike të Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Eksperimental;

1.4. Duke mbajtur në konsideratë se rendi kushtetues, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, janë bazat e shtetit shqiptar, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë;

1.5. Duke vlerësuar nevojën urgjente që ka arti dhe kultura për më shumë mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit, ndërtimin e ambienteve të reja në funksion të artit dhe kulturës, si dhe nevojën që ekziston për ruajtjen dhe restaurimin e plotë të ndërtesës së Teatrit Kombëtar;

1.6. Duke qenë të ndërgjegjshëm se pronat publike janë pasuri e të gjithë qytetarëve, dhe se nuk mund të tjetërsohen, duke cënuar interesin publik, për qëllime fitimi nga biznesi privat;

1.7. Duke e konsideruar miratimin e një ligji të posaçëm për të rregulluar procedurën për realizimin e një projekti publik-privat, konkret dhe individualisht të përcaktuar, si një precedent të rrezikshëm për interesin publik dhe që rrezikon thelbësisht barazinë përpara ligjit dhe lirinë ekonomike;

1.8. Duke mbajtur në konsideratë se mbrojtja e interesit publik dhe e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit, si dhe duke qenë të ndërgjegjshëm se aktualisht jemi në një moment ballafaqimi historik, mes demokracisë shqiptare të rrezikuar dhe totalitarizmit të shfaqur;

1.9. Me vendosmërinë për të kontribuar në ndërtimin e një shteti të së drejtës, dhe një shoqërie demokratike që garanton liritë dhe të drejtat e njeriut, në një sistem politik demokratik që garanton llogaridhënien dhe kufizimin e pushtetit;

DEKLAROJMË ME PËRGJEGJËSI TË PLOTË PUBLIKE NDËRMARRJEN E KËTIJ ZOTIMI:

I. Lidhur me Teatrin Kombëtar:

1. “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit” shpreh vendosmërinë për të vijuar pandërprerje betejën për mbrojtjen e kompleksit shumëfish historik e kulturor, në të cilin funksionojnë aktualisht dy teatrot, ai Kombëtar dhe ai Eksperimental.

2. Partia Demokratike dhe opozita e bashkuar angazhohet të mbështesë veprimet dhe aksionet e “Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit” për mbrojtjen e ndërtesës historike të Teatrit Kombëtar dhe njëherësh për mbrojtjen e pronës publike të kërcënuar nga tjetërsimi i paligjshëm dhe korruptiv, duke përfshirë ndërmarrjen e çdo aksioni, të duhur e të nevojshëm, ligjor, politik e qytetar.

3. Brenda 1 muaji nga momenti kur Partia Demokratike e Shqipërisë dhe opozita e bashkuar do të jetë shumicë politike qeverisëse, kompleksit të ish-Qarkut “Skanderbeg”, ku përfshihet edhe Teatri Kombëtar dhe zonat përreth tij, do t’i rikthehet me përparësi statusi “Ansambël Monument Kulture”, duke qenë pjesë e Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës.

4. Në momentin kur Partia Demokratike e Shqipërisë dhe opozita e bashkuar do të jetë shumicë politike qeverisëse, kompleksi i ish-Qarkut “Skanderbeg”, ku përfshihet edhe Teatri Kombëtar dhe zonat përreth tij, do t’i nënshtrohen ruajtjes dhe restaurimit të tyre, duke tërhequr në një sipërmarrje të tillë përvojën dhe ekspertizën e arkitektëve dhe ekspertëve të monumenteve të kulturës më të mirë në vend.

5. Brenda 1 muaji nga momenti kur Partia Demokratike e Shqipërisë dhe opozita e bashkuar do të jetë shumicë politike qeverisëse, do të shfuqizojë me përparësi si antikushtetues ligjin nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe i godinës së re të Teatrit Kombëtar”, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që buron prej tij dhe parashikon tjetërsimin e paligjshëm të pasurisë publike.

6. Në momentin kur Partia Demokratike e Shqipërisë dhe opozita e bashkuar do të jetë shumicë politike qeverisëse, do të ndërmarrë të gjitha masat e duhura ligjor për të garantuar vënien përpara përgjegjësisë penale dhe administrative të të gjithë vendimmarrësve publikë dhe subjekteve private, për përfshirjen në aferën e grabitjes kriminale të truallit të Teatrit Kombëtar, duke u ngarkuar atyre edhe detyrimin për kompensimin e çdo dëmi të shkaktuar.

II. Lidhur me masat për të garantuar demokracinë funksionale, sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e interesit publik:

1. Në momentin kur Partia Demokratike e Shqipërisë dhe opozita e bashkuar do të jetë shumicë politike qeverisëse, do të ndërmarrë çdo iniciativë të mundshme ligjore, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përfshirë shtesa dhe ndryshime në legjislacionin në fuqi, për të garantuar që çdo investim e zhvillim i realizuar në pronën publike, të tjetërsuar në kundërshtim me ligjin dhe/ose për motive të dyshuara si korruptive, do t'i kthehet publikut nëpërmjet konfiskimit dhe/ose kthimit të pronës në gjendjen e mëparshme.

2. Në momentin kur Partia Demokratike e Shqipërisë dhe opozita e bashkuar do të jetë shumicë politike qeverisëse, do të ndërmarrë çdo veprim ligjor të mundshëm, si dhe do të miratojë çdo akt ligjor e nënligjor të nevojshëm, që çdo subjekt privat që ka ndërmarrë veprime aktive apo ka bashkëpunuar në shkatërrimin e pronës publike, sipas rasteve të përmendura në pikën II/1, do të detyrohet sipas ligjit për dëmshpërblimin e dëmit të shkaktuar dhe rehabilitimin e plotë të zonës dhe pasurive publike, nëpërmjet kthimit të tyre në gjendjen e mëparshme.

3. Në momentin kur Partia Demokratike e Shqipërisë dhe opozita e bashkuar do të jetë shumicë politike qeverisëse, me qëllim përmbushjen e plotë të angazhimeve të përmendura në këtë zotim publik, do të ngarkojë një strukturë të posaçme pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, për hartimin dhe ndjekjen e një strategjie të plotë ligjore, si dhe ndërmarrjen e çdo veprimi të duhur ligjor, që mundëson njëkohësisht realizimin e angazhimeve si më sipër dhe mbrojtjen e interesit publik.

4. Partia Demokratike dhe opozita e bashkuar angazhohet të propozojë një reformë ligjore dhe institucionale për rritjen e përfshirjes dhe pjesëmarrës së publikut në vendimmarrje nëpërmjet garancive të mjaftueshme ligjore për konsultimin efektiv me

qytetarët dhe realizimin e demokracisë së drejtpërdrejtë nëpërmjet referendumeve mbi çështje të interesit publik;

5. Partia Demokratike dhe opozita e bashkuar angazhohet për një sistem zgjedhor që u jep mundësi qytetarëve të shprehen për përfaqësuesit e tyre dhe një reformë kushtetuese që synon rritjen e kontrollit dhe balancës ndërmjet pushteteve apo forcimin e llogaridhënies dhe kontrollit ndaj pushtetit. Diskutimi mbi këtë çështje duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë në hartimin e tyre përfaqësues të të gjitha grupeve të interesit dhe shoqërisë civile.

II. Lidhur me nevojën për një Reformë të vërtetë në art dhe kulturë:

Brenda 1 viti nga momenti kur Partia Demokratike e Shqipërisë dhe opozita e bashkuar do të jetë shumicë parlamentare, në konsultim me komunitetin e artistëve, do të nisë një proces të hapur dhe gjithëpërfshirës, për reformimin e sektorit të artit dhe kulturës në vend që synon:

1. Decentralizimin e institucioneve kulturore në dakordësi me komunitetin artistik dhe shndërrimin e institucioneve buxhetore të artit e kulturës në institucione të pavarura publike;

2. Reformimin e kuadrit ligjor për të garantuar statusin dhe të drejtat e profesionit të artistit, përfshi shpërblimin monetar të tyre;

3. Garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të autorit në Shqipëri;

4. Rritjen e buxheteve për artin dhe kulturën në nivelet më të larta të rajonit.

PËR KËTË QËLLIM:

Palët nënshkruese janë mirëkuptuar për të punuar së bashku dhe të ftojnë të gjithë qytetarët për të kontribuar në përmbushjen e objektivave të përfshira në këtë zotim publik.

Palët nënshkruese angazhohen të informojnë dhe konsultohen me njëra-tjetrën, për mënyrën e përmbushjes në kohë të angazhimeve të përmendura në këtë Deklaratë. Organizatat përfaqësuese të aktorëve, grupet e interesit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, gëzojnë të drejtën të kërkojnë në çdo kohë informacion të plotë, si dhe

përbushjen e këtyre angazhimeve, duke ndjekur çdo mekanizëm dhe duke ndërmarrë çdo veprim që e vlerësojnë të nevojshëm për të garantuar realizimin e tyre.

Një kopje e nënshkruar e kësaj Deklarate [Kontrate] bëhet publike në faqet zyrtare të internetit të palëve nënshkruese, si dhe i bëhet me dije opinionit publik, në format dhe mënyrat më të përshtatshme.

Publikimi i kësaj Deklarate konsiderohet edhe informim me mjete të përshtatshme, i çdo subjekti privat që parashikon të përfshihet në veprime aktive apo të bashkëpunojë në shkatërrimin e ndërtesave dhe zonës përreth Teatrit Kombëtar, duke përfutur pasuri publike, nëpërmjet tjetërsimit të paligjshëm të tyre, sipas arsytimit kushtetues e ligjor të shprehur në Dekretin e Presidentit të Republikës për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 37/2018 në Kuvendin e Shqipërisë. Çdo veprim i kryer nga tani e në vijim do të konsiderohet ligjërish si i kryer në keqbesim.

Me garancinë për përbushjen e plotë të saj, të shprehur nëpërmjet përmbajtjes dhe nënshkrimit publik të kësaj Deklarate:

PALËT E PËRFSHIRA NË KËTË ZOTIM PUBLIK:

Për Partinë Demokratike të Shqipërisë
dhe Opozitën e Bashkuar:

Kryetari

Lulzim Basha
Lulzim BASHA

Mirëza Ismaili

ARK. ASTRIT SERANAJ

Për Aleancën për Mbrojtjen e Teatrit:

Robert Berbi

Valentina Juri

Walter Kuci

Marin Gjoni

Andi Tepelena

Endrit Yzeiri

Andri Kuleva

Adriana Tolka

Lindita Komari
Else Duro elmaduro